



Në mbështetje të nenit 59 dhe 62 të Ligjit Nr. 03/L-163, për Miniera dhe Minerale si dhe në pajtim me nenin 5, nenin 6, nenin 7 paragrafi 1.6, 3.1 si dhe nenin 13 paragrafi 1.16 të Ligjin Nr.04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, Rregulloren 06/2011 për Sigurinë Minerare, Bordi i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, në mbledhjen e mbajtur me 25.03.2016 nxjerr këtë:

UDHËZIMI ADMINISTRATIV**Nr. 05/2016****PËR RREGULLAT E PAJISJEVE PERSONALE MBROJTËSE DHE UNIFORMËN ZYRTARE PËR ZYRTARËT E TERRENIT NË KPMM****Neni 1
Qëllimi**

- Me këtë udhëzim KPMM ka për qëllim përmirësimin e kushteve të punës si dhe përmirësimin e shkallës së siguri të shëndetit të punësuarve në punë, ashtu siç parashihet me Ligjin Nr.04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.
- Po ashtu qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave me të cilat caktohen standarde dhe specifikat e pajisjet mbrojtëse në punë dhe uniformave zyrtare për zyrtarët e KPMM-së që kryejnë punë në terren (jashtë zyrave të KPMM-së).

**Neni 2
Fushëveprimi**

- Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohen rregullat përfurnizimin, shfrytëzimin dhe përdorimin e pajisjeve personale mbrojtëse dhe të uniformës (trobave) zyrtare, standardi i pajisjeve mbrojtëse dhe uniformave, forma dhe sezonet e përdorimit, si dhe masat ndëshkuese për Zyrtarët e terrenit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM).
- Ky Udhëzim Administrativ vlen për të gjithë zyrtarët e KPMM-së që në përshkrimin e detyrave të punës kanë punën në terren. Stafi i cili mund të përdorë Uniformën Zyrtare nga zyrtarët e terrenit janë:

- 2.1.1 Anëtarët e Bordit Drejtues
- 2.1.2 Drejtori
- 2.1.3 Inspektorët
- 2.1.4 Gjeologët

Rr. Armend Daci Nr.1
Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (38) 240 252
Fax: +381 (38) 245 844
E-mail: ICMM@kosovo-mining.org
Web: www.kosovo-mining.org

Kuvendi i Kosovës
Skupština Kosova
Assembly of Kosovo

2.1.5 Gjeodetët

2.1.6 Inspektorët e financave

3. Me vendim të Drejtorit të KPMM-së me uniformë zyrtare, uniforma reprezentative dhe me pajisje personale mbrojtëse mund të pajiset edhe ndonjë anëtar tjetër i KPMM-së të cilit i nevojitet për kryerjen e detyrave të caktuara reprezentative për KPMM.

Neni 3
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë këtë kuptim:

- 1.1. **KPMM- nënkupton Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale;**
- 1.2. **Pajisje mbrojtëse** – janë të gjitha pajisjet të cilat shërbejnë për mbrojtje në punë dhe të cilat janë të domosdoshme për punën e stafit në terren.
- 1.3. **Uniformat** – në kuptim të këtij udhëzimi administrativ janë rrobat zyrtare të terrenit, që kanë dizajn dhe specifika unike të cilat i dallojnë inspektorët dhe zyrtarët e terrenit të KPMM-së.
- 1.4. **Uniformat reprezentative** - në kuptim të këtij udhëzimi administrativ janë rrobat zyrtare në rastet e prezantimit të KPMM-së në takime dhe konferenca të ndryshme brenda dhe jashtë vendi.
- 1.5. **Zyrtarët e terrenit** – janë të gjithë zyrtarët e KPMM-së që kanë punë jashtë zyrave të KPMM-së dhe të cilët për shkak të angazhimeve dhe punës që kryejnë kanë nevojë për pajisje mbrojtëse dhe uniforma.
- 1.6. **Standard i pajisjeve mbrojtëse dhe uniformave** – paraqet një normë apo kërkesë lidhur me specifikat e pajisjeve mbrojtëse dhe uniformave, dhe paraqet një kriter formal.
- 1.7. **Blerja e pajisjeve dhe uniformave** – ka kuptimin e blerjes dhe furnizimin e KPMM-së me pajisje dhe uniforma sipas kërkesave të këtij udhëzimi duke u bazuar në procedurat ligjore të rregulluara me ligj.
- 1.8. **Specifikat teknike** – paraqesin të gjitha specifikat e pajisjeve mbrojtëse për punë dhe uniformave, duke përfshirë materialin, formën, standardin, vetit si dhe cilësinë e produkteve.

1.9. Rrezik – mundësia që të punësuarit t'i shkaktohet plagë, sëmundje ose probleme shëndetësore të menjëherëshme apo të mëvonshme, si rezultat i ekspozimit në ambientin e punës ku paraqiten elemente të dëmshme kimike, fizike dhe biologjike, mjeteve të punës dhe makinerive pa pajisje mbrojtëse dhe të pasigurta për përdorim, mënyrës së gabuar të përdorimit të mjeteve të punës dhe makinerive si dhe mënyrës së gabuar të organizimit të punës;

1.10. Masat ndëshkuese – janë masat verbale, me shkrim, vërejtje dhe masat disiplinore që duhet të merren ndaj çdo zyrtari të KPMM-së i cili vepron në kundërshtim me këtë udhëzim administrativ.

Neni 4 **Standardi i Pajisjeve mbrojtëse dhe Uniformave**

1. Pajisjet mbrojtëse dhe uniformat e rrobave zyrtare të cilat sigurohet sipas Udhëzimit Administrativ duhet që sipas kualitetit dhe destinimit t'i përgjigjen standardeve për përdorimin në miniera dhe të jenë në harmoni me dispozitat për mbrojtje dhe siguri në punë nga rreziqet e ndryshme që paraqiten.

2. Lejohet përdorimi vetëm i atyre pajisjeve mbrojtëse dhe uniformës - rrobave zyrtare për të cilat prodhuesit përveç udhëzimit për përdorim me anë të testit vërteton se ato janë prodhuar sipas standardit dhe dispozitave në fuqi, me të cilat përcaktohen kushtet të cilat duhet t'i plotësojnë.

3. Pajisjet mbrojtëse dhe Uniformat duhet të kenë një afat të caktuar të përdorimit dhe atë në një afat se paku prej 2 viteve dhe për ketë kontraktuesi duhet të paraqet garancinë lidhur me afatin e caktuar të përdorimit.

4. Në rast se Pajisjet mbrojtëse dhe Uniformat pësojnë dëmtime brenda periudhës 2 vjeçare pa fajin e përdoruesit, atëherë kontraktuesi është i obliguar ato t'i ndërroj me pajisje të reja.

5. Përjashtimisht në rast se pajisja mbrojtëse dhe uniforma e rrobave zyrtare dëmtohet para kalimit të afatit të normativit personelit i jepen pajisjet e reja mbrojtëse dhe uniforma e re zyrtare me kërkesën e përgjegjësit të departamentit, dhe me aprovin final nga Drejtori i KPMM-së.

6. Forma dizajni dhe ngjyra e uniformave për stafin e terrenit duhet të jetë unike. Ndryshimi i formës, dizajnit ose ngjyrës bëhet vetëm me vendim të Drejtorit të KPMM-së.

6.1. Ndryshimi mund të bëhet vetëm pas kalimit të afatit të përdorimit (dy viteve).

Neni 5
Furnizimi me Pajisje mbrojtëse dhe Uniformave

1. Furnizimi me pajisjet mbrojtëse dhe uniformat nga KPMM-ja do të bëhet çdo dy vite.
2. Procedura e blerjes dhe furnizimit kryhet sipas Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik.
3. Furnizimet për rroba vere duhet të bëhet më së largu në muajin Prill të vitit përkatës ndërsa të dimrit jo më larg se muaj Tetor.
4. Ky afat mund të ndryshoj vetëm për shkak të rrethanave teknike dhe procedurale që parashihen me Ligjin në fuqi për Prokurimin Publik.

Neni 6
Përdorimi

1. Pajisjet mbrojtëse dhe uniformat duhet të shfrytëzohen vetëm gjatë kryerjes së detyrave të punës dhe kohës që ndërlidhet me orarin e punës apo edhe jashtë orarit të punës nëse ky orar i punës është i aprovuar nga kryesuesi i departamentit.
2. Dhënia për përdorim e pajisjeve dhe uniformave personave tjeter që nuk janë punëtor të KPMM-së është keqpërdorim dhe abuzim me detyrën zyrtare, përbën shkelje të këtij udhëzimi administrativ dhe është subjekt i masave ndëshkuese.

Neni 7
Sezonet e Përdorimit

1. Uniformat do të dallohen sipas sezont të mbajtjes në ato verore dhe dimërore dhe do të përdoren në përputhje me sezonet gjatë vitit.
2. Sezoni i verës fillon në Prill dhe mbaron në Tetor, ndërsa sezoni i dimrit fillon në Tetor dhe mbaron në Prill. Përshtatja e uniformave bëhet duke u bazuar në kushtet klimatike.

Neni 8
Kartelat identifikuese dhe jelekët

1. Zyrtarët e KPMM gjatë punës në terren janë të obliguar që t'i mbajnë kartelat identifikuese të KPMM-së në mënyrë të dukshme dhe në pjesën e sipërme të uniformës apo të varura rrëth qafës.

2. Kartelat identifikuese duhet të jenë në kornizë rezistuese ndaj gërvishtjeve dhe ujit.

Neni 10
Pajisjet mbrojtëse dhe uniformat

1. Pajisjet mbrojtëse dhe uniformat përfshinë:

- 1.1. Këpucë Vere dhe dimri,
- 1.2. Pantallona verë/dimër,
- 1.3. Jakne –Verë /Dimër
- 1.4. Maicë vere,
- 1.5. Këmisha Vere,
- 1.6. Çizme gome,
- 1.7. Helmetë mbrojtëse,
- 1.8. Syze,
- 1.9. Dorëza mbrojtëse,
- 1.10. Rrip-brez sigurues,
- 1.11. Çanta për punë
- 1.12. Jeleku vezullues-obligativ të vishet në vend-punishte.

Neni 11
Specifikat e Pajisjeve mbrojtëse dhe uniformat

1. KPMM duhet të ju përbahet këtyre specifikave:

1.1. **Këpucë Vere dhe dimri (meshkuj/ femra):** Këpucë të kualitetit të lartë. Modeli elegant ose tereni me dizajn qe i përshtaten zyrtareve administratave të uniformuara, të jenë komode për ecje modeli me apo pa lidhëse dhe të jenë të standardizuara, të jenë rezistues ndaj ujit dhe vajrave të ndryshëm, si dhe të kenë astar të brendshëm. Këpucë dimri të thella dhe rezistues ndaj ngricave dhe rrëshqitjeve.

1.2. **Pantallona verë/dimër:** Pantallona qe i përshtaten dhe të uniformuara, modern - elegant të kualitetit të lartë, që mund të pastrohen dhe thahen, material qe e ruan ngjyrën, të mund të barten me rrip brezi.

1.3. **Jakne –Verë /Dimër:** kualitetit të lartë, e qëndrueshme ndaj ujit dhe frysës, dizajni që i përshtaten zyrtarëve administrativ e uniformuara për sezonin e dimrit dhe verës, e izoluar thelle me astar. Me qepje për vendosjen e epoletave mbi supe, të janë me patentë . Mund të lahet dhe thahet, material qe e ruan ngjyrën, patentë rezistues në një apo dy drejtime në anën e përparme,

1.4. **Maica Vere:** të përshtatshme për punë tereni, duhet të jenë me logo të KPMM-së.

[Handwritten signature]

1.5. Këmisha Vere: të përshtatshme për punë tereni, duhet të jenë me logo të KPMM-së.

1.6. Çizme gome: Çizmet duhet të jenë me dy apo me shumë shtresa të mbuluara me masat mbrojtëse në gishta dhe thembër dhe shputa duhet të jetë e punuar me dy e me tepër shtresa ku njëra duhet të jetë e hekurt. Rezistuese ndaj rrëshqitjeve, goditjeve dhe depërtimit të ujit. Të kenë shenja vezulluese reflektuese në thembër.

1.7. Helmet mbrojtëse: Helmeta duhet të jetë e përshtatshme, duhet të përbaj mekanizmin përvendosjen e llambës dhe të jetë sipas standardeve.

1.8. Syze mbrojtëse: Syzat nuk duhet të kenë dioptri. Syzat duhet të jenë të dy llojeve të tejdikshme për minierat nëntokësorë apo vendet e errëta dhe të errëta në minierat sipërfaqësore ku ka dritë të ngopur.

1.9. Dorëzat mbrojtëse: Dorëzat duhet të jenë punuara nga materialet rezistuese ndaj të ftohtit dhe ujit, të jenë të përshtatshme dhe elastike.

1.10. Rrip brezi: duhet të jetë i materialit të fort, i atestuar të jetë i përshtatshëm për rroba të punës.

1.11. Jelek Vezullues: duhet të jetë me ngjyrë reflektuese, të qëndrueshme rezistues ndaj të gjithë faktorëve të tjerë, si p.sh. gërvishjeve dhe Jelekët duhet të jenë me logo të KPMM-së.

1.12. Çanta për punë: Duhet të jenë të punuara nga materiali i fortë me shumë gjepë, rezistues ndaj ujit, të jenë të përshtatshme për bartje dhe të jenë të madhësisë që i përbush kriteret dhe ka hapësira për bartje të uniformave dhe mjetet tjera të punës.

2. Varësish nga mjetet buxhetore në raste të caktuara mund të mos blihen të gjitha pajisjet që janë të përshkuara në nenin 10 të këtij udhëzimi administrativ.

Neni 12 **Specifikimet teknike të uniformes dhe këpucëve të terrenit**

1. Veshmbathjet e terrenit duhet të jenë sipas specifikimeve teknike të bashkangjitura. Specifikimet mund të ndryshojnë varësish nga kërkesat e KPMM-së nga viti në vit. Për pajisjet tjera të terrenit specifikimet do të përgatiten nga njësia e kërkesës në momentin e kërkesës për blerje. Ngjyra e uniformave duhet të jetë e përshtatshme dhe mund të caktohet nga viti në vit.

Neni 13 **Mirëmbajtja e Pajisjeve mbrojtëse - Uniformave**

1. Pajisjet mbrojtëse dhe uniforma duhet të jenë të pastra dhe në gjendje të rregullt.

2. Mirëmbajtja e pajisjeve mbrojtëse dhe uniformave duhet të bëhet nga Zyrtaret të cilët përdorues të tyre.

Neni 14
Masat Ndëshkuese

1. Mos përdorimi i pajisjeve mbrojtëse dhe uniformave në terren nga zyrtaret e përcaktuar me nenin 2 të këtij udhëzimi përbën shkelje disiplinore.
2. Çdo ndryshim i uniformave standarde të krijuara në bazë të këtij UA mban përgjegjësin vetë zyrtari dhe paraqet shkelje të disiplinore.
- 2.1. Mos respektimi i uniformës zyrtare paraqet shkelje disiplinore dhe për këtë do të aplikohen sankzionohet.
3. Mosrespektimi i këtij udhëzimi dhe uniformës zyrtare përbën shkelje disiplinore i cili do të ndiqet sipas “Kodi i Mirësjelljes për Nëpunësit Civil Nr. 01/2006” dhe dispozitave tjera në fuqi.

Neni 15
Dispozitat Kalimtare

1. Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
2. Me hyrjen e fuqi të këtij udhëzimi administrativ shfuqizohet Udhëzimi Administrativ Nr.02/2010 KPMM i datës 26.03.2010.



Musa Shabani
Kryesues i Bordit
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale

ANEKSI 1
SPECIFIKAT TEKNIKE

ANEKS-1

SPECIFIKIMET E DETYRUESHME TEKNIKE

Artikulli		Specifikimi
1.	Këpuce Vere M/F	<p>Këpuce Vere (meshkuj & femra).</p> <p>Lëkurë e qëndrueshëm ndaj ujit dhe njehërit lejon ajrosjen Teknologji me karakteristikë të petëzuar, me sistem klimatik, e papërshkueshme nga uji, që ajroset Lartësia e këpucës nga pjesa e brendshme 7.5 cm, antistatike</p> <p>Materiali i Sipërm Lëkurë, hidrofobike, ajrosëse ,1.6 – 2.0 mm e trashë</p> <p>Astari i Brendshëm Teknologji me karakteristika të petëzuar 4-shtresa ,i petëzuar, i qëndrueshëm ndaj ujit dhe njehërit lejon ajrosjen. Astar i qëndrueshëm ndaj fërkimeve të larta, me shtrese të mesme lesi. Lejon bartjen e këpucëve për të gjitha stinët e vitit. Mbrojtje ndaj materieve kimike.</p> <p>Shtrati i shputës I formuar në mënyrë anatomike, i këmbyeshëm, që mund të lahet, thithë shumë mirë lagështinë, thahet shpejt. Shtroja e shputës te thithë djersën dhe lagështinë</p> <p>Shtresa e jashtme e shkelëses Gomë për ecje në rrugë dhe terren. Ecje optimale dhe të lakohet ne gishta dhe rrumbullakimit të thembrës. Peshë të lehtë. Rezistues ndaj naftës dhe benzinës, që nuk lë shenja. Në përputhje me EN ISO (Standardin adekuat per pajiset mbrojtëse në pune). Madhesit e kerkuara- sipas listes se bashkangjitur,standarti i EU-se. Garancioni Minimum 2 vite.</p>
2.	Kepucë Dimri M/F	<p>Këpuce Dimri ((meshkuj & femra).</p> <p>Të thella apo gjysmë të thella</p> <p>Lëkurë e qëndrueshëm ndaj ujit dhe njehërit lejon ajrosjen Teknologji me karakteristika të petëzuar, me sistem klimatik, e papërshkueshme nga uji, që ajroset Lartësia e këpucës nga pjesa e brendshme 7.5 cm, antistatike</p> <p>Materiali i Sipërm Lëkurë, hidrofobike, ajrosëse ,1.6 – 2.0 mm e trashë</p> <p>Astari i Brendshëm Teknologji me karakteristikë të petëzuar 4-shtresa ,i petëzuar, i qëndrueshëm ndaj ujit dhe njehërit lejon ajrosjen. Astar i qëndrueshëm ndaj fërkimeve të larta, me shtrese të mesme lesi. Lejon bartjen e këpucëve për të gjitha stinët e vitit. Mbrojtje ndaj materieve kimike.</p> <p>Shtrati i shputës I formuar në mënyrë anatomike, i këmbyeshëm, që mund të lahet, thithë shumë mirë lagështinë, thahet shpejt. Shtroja e shputës te thithë djersën dhe lagështinë</p> <p>Shtresa e jashtme e shkelëses Gomë për ecje në rrugë dhe terren. Ecje optimale dhe të lakohet ne gishta dhe rrumbullakimit të thembrës. Peshë të lehtë. Rezistues ndaj naftës dhe benzinës, që nuk lë shenja. Në përputhje me EN ISO (Standardin adekuat per pajiset mbrojtëse në pune). Madhesit e kerkuara- sipas listes se bashkangjitur,standarti i EU-se. Garancioni Minimum 2 vite.</p>
3.	Pantollona Dimri	<p>Pantollona të Meshkujve -Dimri</p> <p>MATERIALI</p> <p>Përberësit: 60-70 % Poliestër, 30-40% pambuk; duhet te jene te qëndrueshme ndaj grisjes dhe te jene te trajtuara me teflon për qëndrueshmëri ndaj njollave dhe ujit. Xhepat: 60-70% Poliestër 30-40% Pambuk.</p> 

		VEÇORITË Pjesa te beli me zgjerim përmes sistemit elastik me tunel; xhepa të thellë përpara; xhepa të mëdhenj dhe 2- xhepa me ndarje shtese brenda; Xhepa prapa me kapak. Pantalonat duhet te kenë pjesën e gjurit të dyfishtë me material, dhe rripa sigurie të dyfishtë të vetë materialit. Hapja e këmbëve te ketë shtresë të dyfishtë tërheqëse.
		ETIKETAT : Një etiketë logo e thurjes, një etiketë për kujdes, një etiketë për madhësi, etiketë e vendit të origjinës dhe etiketë të përbajtjes së fibrës të ngjitur përherë në pantallona. Madhesit e kerkuara- sipas listes se bashkangjitur, standarti i EU-se. Garancioni minimum 2 vite.
4.	Pantollona Vere	Pantollona Vere LLOJI I MATERIALIT: Përbërësit: Poliestër elastik mekanik 25-45%, Poliestër 20-30%, dhe pambuk 30-40% Xhepat: 70-80% Poliestër 20-30% , i qëndrueshëm ndaj njollave Xhepat te janë të thellë. Xhepat prapa janë me mbyllje kapaku Pjesa e gjurit duhet te kete shtrese te dyfishtë me shtesa të mbushjes së gjurit me qasje nga brenda. MBYLLJET: Patenti është patent metalik. Kopsa e belit është kopsë metalike. Garancioni minimum 2 vite.
5	Jakne Dimri	Jakne Dimri LLOJI I MATERIALIT: Xhaketa e jashtme me kapele: Shtresa e jashtme është 100% Najlon me ajrosje me ose pa xhaket te brendshme Xhaketa e Brendshme: e butë 100% Poliestër VEÇORITË DHE PËRFITIMET: xhaketë najloni e qëndrueshme ndaj ujit, xhaketë e brendshme me material të butë, dhe të dyja mund të vishen njëkohësisht si një xhaketë. Xhaketa ka ne pjesën e jashtme xhepa vertikal në kraharor, xhepa dore, dhe xhepa ne mëngë. Te ketë pjesën e mjekrës me material te bute te përshtatshme dhe mbrojtje nga fërkimet. Xhaketa e jashtme: Xhaketa e jashtme është e qepur dhe e ngjitur me tegel plotësisht te vullkanizuar per rezistence ndaj ujit, e qëndrueshme ndaj erës dhe duhet te jetë me material qe lejon ajrosjen. E tëra e qëndrueshme ndaj ujit, kapela e përshtatshme dhe duhet te kete mundësinë e palosjes ne jake dhe mundësinë e zhvendosjes tërësisht. Duhet të ketë panela për ID me mundësi te heqjes në kraharorin e majtë dhe në shpinë. Panela e lidhëses së shenjës dalluese në kraharorin e djathtë. Pulla rezervë duhet te jetë e përfshirë. Sistemi i patentit të qepur anash për ajrosje te mjaftueshme.

		Xhaketa e brendshme: Xhaketa e brendshme është punuar nga materiali i qëndrueshëm ndaj erës, material i bute (softshell). Xhepat e dorës dhe xhepat në kraharorin duhet te kenë patenta rezistent ndaj ujit që të mos futet uji brenda ne ta. Kapëse çelësash brenda xhepit të majtë. ETIKETAT: Çdo xhaketë duhet te ketë një etiketë për kujdes, një etiketë për madhësi, etiketë të vendit të originës dhe të përbajtjes së jaknes të ngjitur përherë në veshje. NGJYRAT: E zezë ,dhe kafe e qelet(Tundra) ose varësisht nga kërkesa. Garancioni minimum 2 vite.
6.	Jakne Vere	Jakne Vere LLOJI I MATERIALIT: Xhaketa e jashtme me ose pa kapele: Shtresa e jashtme është 100% Najlon me ajrosje me ose pa xhaket te brendshme Xhaketa e Brendshme: e butë 100% Poliestër VEÇORITË DHE PËRFITIMET: xhaketë najloni e qëndrueshme ndaj ujit, xhaketë e brendshme me material të butë, dhe të dyja mund të vishen njëkohësisht si një xhaketë. Xhaketa ka ne pjesën e jashtme xhepa vertikal në kraharor, xhepa dore. Duhet te ketë panela për ID me mundësi te heqjes në kraharorin e majtë ose te djatht ose në shpinë. Sistemi i patentit të qepur anash për ajrosje te mjaftueshme. NGJYRAT: E zezë ,dhe kafe e qelet(Tundra) ose varësisht nga kërkesa. Garancioni minimum 2 vite.
7.	Maica Vere	Bluza -Maica Profesionale e Meshkujve LLOJI I MATERIALIT: 100% Pambuk VEÇORITË DHE PËRFITIMET: 100% Pambuk rezistent ne rrudhosjen, dhe tkurrjen. Pulla të forta me jakë fleksibile që qëndron e ngjitur për skajet e jakës Qafa prapa në gjysmë hënë për rehati të shtuar Xhep ne pjesën e përparme ne anën e majtë . NGJYRA E bardhë, Hiri,e Zezë, Teget ose varësisht nga kërkesa. Garancioni minimum 2 vite.
8.	Këmisha	Këmisha LLOJI I MATERIALIT: materiali i jashtëm: duhet te jetë material me peshë të Lehtë Ripstop, 60-70% Poliestër /30-40% Pambuk, Astari: Rrjet Poliestër, 100% Poliestër.

		<p>DIZAJNI, VEÇORITË DHE FINISH</p> <p>Bluza do të përfshij dy (2) xhepa kraharori me kapak me mbyllje grepi dhe laku, dhe dy xhepa të fshehtë për dokumente. Bluza vjen me hapje që janë të përforuar për stabilitet. Bluza vjen me veçori të shiritit të manshetave profesional me katër palë të mëngës dhe manshetat të përshtatshme. Mëngët i kanë të përforuar pjesët e bërrydit.</p> <p>DIZAJNI I XHEPIT:</p> <p>Dy xhepa kraharori kanë palosje të kthyer.</p> <p>FINISHI : Profesional është i kryer me Teflon, kundër rrudhave dhe finishit kundër venitës.</p> <p>ETIKETAT : Kujdesi, madhësia, vendi i origjinës, përbajtja dhe informacioni i logos janë të qepura përherë.</p> <p>Garancioni minimum 2 vite.</p>
9.	Rrip Brezi	<p>Rrip (meshkuj). Rrip brezi me i gjere. Model elegant, te përshtatet me uniforme dhe mbathje, përmajtjen e pajisjeve. Përbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Material kualitativ lekur ose polyester 100% përbajtja nga thurrja • Ngjyrë te zezë <p>Madhësitë e kërkuan- sipas listës se bashkangjitur, standardi i EU-se. Gjerësia e rripit ti përshtatet gjerësisë se vegezave për pantallona.</p> <p>Garancioni minimum 2 vite.</p>
10.	Jelek Vezullue	<p>Shirita reflektues në vlerat retro-reflektues me shirita vertikal dhe tërthor me gjerësi te shiritave nga 5-8 cm. Ti përballojnë larjeve dhe mos te tkurren pas pastrimit dhe te jen rezistues ndaj gërvishtjeve. Te jen te punuara sipas standardeve.</p> <p>Garancioni 2 vite.</p> 